



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada - Government

MINISTRIA PËR DIALOG

RAPORT MBI GJENDJEN NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

Raport i shkurtër mbi progresin dhe sfidat

**RAPORT I DORËZUAR NË BASHKIMIN EVROPIAN/SHËRBIMIN EVROPIAN
PËR VEPRIM TË JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 25 nëntor 2015

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky është një raport i shkurtër mbi progresin dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit gjatë këtij viti, duke përfshirë edhe pakon e marrëveshjeve të 25 gushtit 2015. Raporti paraqet procesin e përgjithshëm të zbatimit të të gjitha marrëveshjeve në vazhden e obligimeve të secilës palë në dialogun e Brukselit.

Matja e performancës së të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, në përmbushjen e detyrimeve të tyre për zbatim, ka për qëllim që t'u ofrojë lexuesve një pasqyrë më të qartë se si është duke shkuar procesi i asaj çfarë jemi pajtuar dhe kemi nënshkruar gjatë dialogut të ndërmjetësuar nga BE/EEAS.

Në përgjithësi marrëveshjet e arritura në dialogun e Brukselit mund të grupohen në tre grupe kryesore:

1. Marrëveshjet për bashkëpunimin bilateral mes dy shteteve – siç janë marrëveshja për MIK-un dhe protokollin teknik, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja rajonale, liria e lëvizjes, tregtia e lirë/ vulat doganore, energji, telekom, SEED-in doganor (apo Shkëmbimin sistematik të të dhënave elektronike), njohja e ndërsjellë e diplomave universitare, njohja e ndërsjellë e sigurimit të automjeteve, njohja e ndërsjellë e CPP-së (certifikatës së produkteve mjekësore), ndihma e ndërsjellë juridike, Zyrrave të Ndërlidhjes dhe marrëveshjes për vizitat zyrtare.

2. Marrëveshjet për normalizimin e situatës në veri të Kosovës – siç janë ajo për funksionimin ligjor komunal në katër komunat veriore, polici, drejtësi, shpërbërjen e Mbrotjtjes Civile, ligjin për amnisti, fondin e zhvillimit, licencimin e kompanive në veri, heqjen e barrikadës nga ura në Mitrovicë. Këto marrëveshje synojnë konsolidimin e sistemit të Kosovës në pjesën veriore të vendit, integrimin e serbëve të Kosovës në sistemin e Kosovës dhe largimin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

3. Marrëveshjet për reparacionet e luftës – siç janë marrëveshjet mbi kthimin e librave themeltar të regjistrimit civil të Kosovës dhe të dhënat kadastrale nga Serbia në Kosovë, të cilat janë marrë nga Serbia gjatë kohës së luftës në Kosovë.

Gjetjet tregojnë që marrëveshjet e grupit një dhe tre kanë shënuar më shumë përparim se ato të grupit të dytë.

Marrëveshjet e grupit të dytë nuk kanë shënuar progres të vërtetë, për arsye të dështimeve të Serbisë për të zbatuar, vonuar ose shkelur ato. Nga të gjitha këto marrëveshje kërkohet konsolidimi i sistemit të Kosovës në pjesën veriore të Kosovës dhe integrimi i serbëve të Kosovës, si dhe largimin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë. Megjithatë, përveç në polici, ku zbatimi është realizuar në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit, fushat e tjera janë përballur ose me zbatim ambivalentë ose

me vonesa të mëdha deri më sot. Në mënyrë që të kuptohen ambivalencat e tilla, si shembull është marrëveshja për zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Kosovë e cila bën thirrjen e katër komunave veriore (Mitrovicën Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviç) për pjesëmarrje. Marrëveshja kishte synim krijimin e funksionimit ligjor të këtyre organeve komunale në pajtim me ligjin e Kosovës.

Megjithatë, në realitet përfundoi në situatë paradoksale ku strukturat ligjore komunale janë duke u penguar nga strukturat paralele të Serbisë në Kosovë, sepse Serbia i mbështet ato, në vend se t'i shpërbëjë ato në përputhje me marrëveshjen e Brukselit. Shembuj të ngjashëm mund të gjenden edhe në fusha të tjera, të theksuara në këtë raport.

Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit dhe vazhdimi i mos largimit të strukturave paralele serbe në Kosovë nuk korrespondojnë me qëllimet e Marrëveshjeve të Brukselit. Mbetet pikëpyetje nëse kjo mund të konsiderohet si zbatim që kemi dashur, kërkuar dhe dakorduar. Ekziston frika se për zbatimin e marrëveshjeve të fushave të tjera si drejtësia, shpërbërja e mbrojtjes civile do të pasohet me modele të ngjashme ambivalente. Padyshim, edhe në qoftë se nuk do të ketë shpërbërje të plotë dhe të verifikuar të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë ka të ngjarë që qëllimet e këtij dialogu të minohen. Për të gjithë ata që vëzhgojnë procesin e zbatimit, fokusin duhet ta vendosin në ekzaminimin e largimit efektiv të strukturave paralele. Është e paimagjinueshme, por e vërtetë se marrëveshja për njohjen reciproke të vulave doganore e vitit 2011 ka kërkuar largimin e vulave paralele dhe zyrave doganore, por ende edhe sot ato vula dhe struktura ilegale ekzistojnë.

Ky dualizëm, i zbatimit të kërkesave të marrëveshjes së Brukselit e në të njëjtën kohë mbajtja e strukturave paralele, i mundëson Serbisë që të raportoj tek BE për progresin e zbatimit, përderisa ende i mban strukturat e saja paralele në Kosovë të pa prekura. Në një mënyrë, pjesa e zbatimit bëhet një mbulesë për ndërhyrje dhe paralelizëm nga Serbia. Sipërfaqësisht duket se marrëveshjet janë duke u zbatuar, por në thellësi ato mbesin kontradiktore dhe larg nga ajo çfarë është rënë dakord në Bruksel. Fakti se ministrat e Qeverisë së Kosovës janë duke u penguar të bëjnë vizita në komunat veriore, flet vetvetiu për situatën aktuale.

Kosova ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit me largimin e plotë të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë. Marrëveshja në parim është arritur në Bruksel që është në paralel me procesin e hartimit të statusit të Asociacionit, ku grupi trepalësh pune do të punojnë në planin për largimin e strukturave paralele.

Kosova pohon se pasi që të konfirmohet largimi i atyre strukturave atëherë do të fillon themelimi i asociacionit.

Në mënyrë që zbatimi të përparojë ndjeshëm, Serbia duhet ta heq Kosovën nga kushtetuta e saj dhe gjithashtu t'i shuaj të gjitha strukturat paralele, për të treguar qëndrueshmëri në angazhimin e saj për dialogun e Brukselit dhe për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, siç parashihet në Kapitullin e 35 të negociatave për anëtarësim në BE.

Mënyra e bërjes së fushatës nga ana e Serbisë që të pengojë anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, ka treguar jo vetëm për shkeljen thelbësore të parimeve themelore të dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve, por edhe ka zbuluar se sa larg është Serbia nga vlerat evropiane.

Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në Dialogun e Brukselit dhe në zbatimin e marrëveshjeve. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka qenë moment historik për rrugën zyrtare të Kosovës në integrimin evropian. Kjo ka ndihmuar Kosovën që të rifreskojë motivimin për të shty përpara reformat evropiane dhe të vazhdojë qasjen e saj të përgjegjshme në dialogun e Brukselit. Vendimi i BE-së për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës paraqet hap të rëndësishëm që Kosova me meritë është duke e pritur.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson lartë bashkëpunimin dhe mbështetjen nga BE si lehtësues i këtij dialogu dhe si një organizatë ku Kosova aspiron anëtarësimin e plotë. Vlerësojmë lartë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë dhe të gjitha vendeve tjera në dialogun e Brukselit dhe në perspektivën euroatlantike të Kosovës në përgjithësi.

GJENDJA E TANISHME NË PROCESIN E ZBATIMIT

1. Zgjedhjet/ funksionimi i brishtë i katër komunave legale veriore me ligjet e Kosovës

- Funksionimi i katër komunave veriore të zgjedhura në zgjedhjet lokale të vitit 2013 të mbajtura në Kosovë vazhdojnë të jenë të brishta për shkak të ndërhyrjeve të Serbisë me strukturat e saja paralele në Kosovë.
- Komunat ende nuk i kryejnë detyrat e veta në pajtim të plotë me ligjet e Kosovës, ashtu siç është kërkuar nga Marrëveshja e parë e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve. Ja disa nga shqetësimet kryesore:
 1. Simbolet, vultat, shenjat dalluese komunale ende nuk janë miratuar nga komunat dhe ndonjëherë shfrytëzojnë disa vula joligjore.
 2. Buxhetet dhe prokurimi nuk bëhen sipas ligjeve të Kosovës
 3. Personeli administrativ ende nuk është i integruar, përveç Mitrovicës së Veriut
 4. Shërbimet publike lokale kryhen kryesisht nga strukturat paralele që mbështeten politikisht dhe financiarisht nga Serbia.
- Serbia ka dështuar që të shuajë strukturat e saja në Kosovë. Ajo ende vazhdon që t'i financojë dhe përkrahë strukturat paralele (p.sh. këshillat e përkohshëm komunalë, personelin e komunës), në vend se të respektoj Marrëveshjen e Brukselit. Siç është raportuar, Serbia vazhdon që të ndajë rreth 500 milion euro në vit për strukturat e saja paralele në Kosovë.
- Serbia po e pengon regjistrimin e popullsisë në katër komunat veriore të Kosovës që është planifikuar të bëhet në vitin 2016. Kjo mund të shihet nga hezitimi i kryetarëve të komunave që të mbështesin regjistrimin, edhe pse është arritur marrëveshja mes tyre dhe Qeverisë së Kosovës në vitin 2014, në këmbim të kërkesës së tyre për të rritur numrin e ulëseve në kuvendet e komunave në Zvečan dhe Zubin Potok (nga katër ulëse secila). Kryetarët refuzuan të takohen me kryesuesin e EUROSTAT-it i cili ka vizituar kohëve të fundit Kosovën me qëllim të ndihmës në përgatitjen e regjistrimit.

2. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë - ende nuk janë shuar

- Serbia ka vazhduar të ndërhyjë në Kosovë duke i mbështetur strukturat e veta paralele që funksionojnë nëpër tërë Kosovën, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, që është në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve.
- Serbia duhet të shuajë strukturat e saja paralele në Kosovë pasi që janë pengesa kryesore për zbatimin e plotë dhe efikas të marrëveshjeve të Brukselit dhe për realizimin e objektivit për normalizimin e situatës në pjesën veriore të Kosovës. Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit nuk mund të konsiderohet i përmbushur nëse në Kosovë vazhdon të ekzistojë paradoksi i veprimit të strukturave legale dhe ilegale.
- Siç është raportuar, këto struktura veprojnë ilegalisht nëpër tërë Kosovën, edhe pse në formë më agresive në pjesën veriore të Kosovës. Sipas dëshmimeve tona, kryetarët ilegalë janë ata që marrin përkrahje politike dhe fonde nga Serbia dhe me fuqinë e tyre joformale minojnë në masë të madhe punën e kryetarëve/organeve komunale të zgjedhur në mënyrë demokratike për të kryer funksionet e tyre në përputhje me ligjet e Kosovës.
- Vetëm disa struktura paralele janë larguar (p.sh. sa i përket policisë), shumica e tyre ende veprojnë, pavarësisht marrëveshjeve të Brukselit. Në disa raste ato janë larguar dhe janë kthyer prapë siç janë zyrat dhe vulat paralele doganore.
- Kosova ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit me largimin e plotë të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë. Marrëveshja në parim është arritur në Bruksel, ku paralelisht me procesin e hartimit statutit të Asociacionit, një grup pune trepalëshe do të punojë në planifikimin e largimit të strukturave paralele. Pas largimit të verifikuar të këtyre strukturave, do të krijohet Asociacioni.

3. Asociacioni i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë

- Zbatimi nuk ka filluar ende – është duke u pritur vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mbi kushtetutshmërinë e marrëveshjes së Brukselit në këtë çështje (e arritur më 25 gusht 2015).
- Kosova ka ndërmarrë masat fillestare për zbatim, duke hartuar një dekret sa i përket pikës 2 të marrëveshjes, e cila është subjekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

- Zbatimi do të ri-fillojë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.
- Ekipi menaxhues po plotësohet me dy anëtarë të rinj që zëvendësojnë ata të cilët nuk mund të shërbejnë në këtë ekip për arsye objektive. Kosova ka kërkuar një karakter më përfaqësues të këtij ekipi, duke pasur parasysh se përbërja fillestare ka reflektuar vetëm katër komunat veriore.

4. Policia

- Në përgjithësi, zbatimi i marrëveshjes mbi policinë ka qenë i kënaqshëm. Strukturat paralele të policisë janë shpërbërë. Më 31 dhjetor 2013, 287 policë Kosovare/Serbë janë integruar në Policinë e Kosovës dhe më 22 korrik të vitit 2013 është krijuar Drejtoria Rajonale. Drejtori Rajonal është serb i Kosovës, ndërsa Zëvendës Drejtori është shqiptar i Kosovës, i emëruar më 25 qershor të vitit 2013.
- Integrimi i stafit administrativ dhe shpërbërja e atij paralel është çështje ende e pazgjidhur. Serbia nuk ka treguar gatishmërinë sa i përket integritit të stafit administrativ Serbë në Ministrinë e Brendshme të Kosovës/Agjencia për Regjistrim Civil. Arsyetja për këtë është e natyrës politike – pengimi i lëshimit të dokumenteve të regjistrimit civil/dokumenteve të shtetësisë së Kosovës në katër komunat veriore në Kosovë. Së fundi, ka pasur disa indikacione nga ndërmjetësuesi i BE-së mbi këtë çështje dhe mbetet të shihet. Kosova e ka planin për integrim të 72 personave sa i përket marrëveshjes.
- Serbia vazhdon të insistojë për integrimin e një numri shtesë të policëve Serbë në policinë e Kosovës, përveç numrave të dakorduar dhe zbatuar.

5. Drejtësia

- Zbatimi i Marrëveshjes për Drejtësi është në proces të finalizimit. Çështja e pazgjidhur sa i përket objekteve dhe stafit mbështetës është zgjidhur, ndërsa shpërbërja e strukturave paralele gjyqësore të Serbisë në Kosovë ende nuk është zgjidhur. Janë dashur më shumë se dy vite për të arritur në këtë fazë.
- Kosova ka përmbushur të gjitha obligimet e saja sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshje.
- Serbia ende nuk ka shpërbërë ligjrisht strukturat e saja paralele gjyqësore në Kosovë. Shpërbërja kërkon ndryshime ligjore në Ligjin e Serbisë Nr. 116/2008 mbi Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorëve. Afati i fundit ishte deri më 31 dhjetor 2013.

- Serbia ende nuk ka shfuqizuar kontratat e punës për personelin gjyqësorë të angazhuar në strukturat paralele gjyqësore, si dhe nuk ka ndalur pagat e tyre.
- Këto struktura, *de-facto*, kanë ndalur operimin që nga viti 2013 sipas marrëveshjes.

Progresi në zbatim është si në vijim:

- Sistemi unitar i drejtësisë i Kosovës do të konsolidohet në pjesën veriore të Kosovës, ku së shpejti do të fillojnë funksionimin një gjykate themelore për shtatë komuna dhe një zyre prokurorie, në përputhje me të ligjet e Kosovës, siç përcaktohet në marrëveshjen e Brukselit.
- Siç jemi dakorduar, Kosova ka hapur në mënyrë të rregullt vende të lira të punës për 48 gjyqtarë serbë dhe 15 prokurorë serbë për tërë territorin e Kosovës. Procesi i përzgjedhjes ka rezultuar në përzgjedhjen e 34 gjyqtarëve dhe 9 prokurorëve. Kosova do të shpallë vende të lira të punës në mënyrë që të plotësojë procesin e integritimit, në kohë të duhur.
- Çështja e stafit mbështetës është zgjidhur. Serbia u vonua gjashtë muaj që të dakordohet me numrin e stafit të propozuar nga ana e Kosovës. Më 13 nëntor 2015, BE-ja informoi në lidhje me dakordimin e Serbisë.
- Çështja e objekteve është zgjidhur. Gjykata themelore – dy ndërtesa, ndërtesa ekzistuese e gjykatës themelore në veri dhe një tjetër ndërtesë e ish-Jugobankës (në Mitrovicën Jugore); një ndërtesë e marrë me qira do të shfrytëzohet për zyrën e prokurorisë (në Mitrovicën Veriore). Objektet për dy degët e gjykatës themelore - në Leposaviq janë të gatshme për t'u shfrytëzuar, edhe pse aktualisht kjo ndërtesë shfrytëzohet nga gjyqtarët serbë që duhet të integrohen; në Zubin Potok, ndërtesa ka nevojë për disa renovime. KGJK-ja do të hap procesin e ri-tenderimit. Planet janë duke u zhvilluar.

6. Shpërbërja e “mbrojtjes civile”

- Zbatimi i Marrëveshjes për shuarjen e “Mbrojtjen Civile - MC” është në proces të finalizimit. Çështja e pazgjidhur është shpërbërja ligjore e kësaj strukture nga Serbia. Janë dashur pothuajse dy vite për të arritur në këtë fazë.
- Kosova ka përbushur 97% të obligimeve të saja për integrimin e ish-anëtarëve të MC në institucionet e Kosovës. Pjesa e mbetur prej 3% do të integrohen javën e ardhshme. Procesi i përzgjedhjes është zhvilluar në përputhje me ligjet e Kosovës. 483 personat e paraparë në përputhje me Planin e Qeverisë së Kosovës për Integrim do të punësohen në një spektër të gjerë të institucioneve civile të Kosovës (shih Shtojcën). 105 personat e parë tashmë janë duke punuar dhe marrin paga nga buxheti i Kosovës që nga shtatori i vitit 2015. Ndërsa, 328 persona do të nënshkruajnë kontratat deri në fund të këtij viti dhe do të fillojnë punën dhe marrjen e pagave që nga 1 janari 2016. Ndërsa, 50 personat e mbetur do të paguhen nga fondi i kontigjencës i Kosovës, ndërkohë që do të punësohen vitin tjetër.
- Serbia ende nuk e ka shpërbërë ligjërisht “Mbrojtjen Civile” e cila ka funksionuar ilegalisht në Kosovë. Serbia duhet të miratojë ndryshimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të ndërpresë ekzistimin e kësaj strukture dhe të ndalojë pagesën për anëtarët e saj, në përputhje me marrëveshjen. Afati i fundit është 1 janari 2016, edhe pse nuk jemi informuar në lidhje me ndonjë progres substancial në këtë çështje.
- Serbia duhet të miratojë ndryshimet në legjislacion në mënyrë që të ndërpresë pagesën e pagave për anëtarët e MC dhe të ndalojë me ofrimin e mbështetjes financiare për MC.
- Serbia duhet të ndryshojë Ligjin për Mbrojtjen në mënyrë që të ndërpresë në mënyrë ligjore funksionimin e MC në Kosovë. Përveç kësaj, ajo duhet të largojë MC nga strukturat organizative të Ministrisë së Brendshme. (Çuditërisht, MC është akomoduar ligjërisht në Ligjin mbi Mbrojtjen, ndërsa struktura e MC në organogramin e Ministrisë së Brendshme të Serbisë).
- Serbia është duke u vonuar në dorëzimin e objekteve të ish MC tek Qeveria e Kosovës.

Progresi në zbatim është si në vijim:

- Serbia, edhe pse me pesë muaj vonesë, ka përfunduar largimin e pikave të vëzhgimit të MC, ku e fundit është larguar ajo afër urës së Mitrovicës.

- Me dy muaj vonesë, Serbia ia ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës pajisjet e MC.
- Ajo i ka konfirmuar me kohë BE-së se stafi i MC nuk do të veshë më uniformat/xhaketë me shenjën Serbe të MC, e veçanërisht nuk do të vazhdojë përdorimi zyrtar i tyre.
- Sa i përket objekteve, Serbia po e vonon dorëzimin e objekteve të ish-MC tek Qeveria e Kosovës. Gjithsej 15 objekte është dashur të dorëzohen jo më vonë se data 20 korrik i vitit 2015. Arsyetimet e pabaza të Serbisë bazohen në arsyetimin që këto objekte i përkisnin komunave. Në kërkesën e Kosovës për që kjo të dëshmohej përmes një certificate e cila dëshmon se këto objekte i përkasin komunave, Serbia ka dështuar në ofrimin e një dokumenti të tillë.
- Qeveria e Kosovës, pas vizitës në terren në ato objekte dhe vlerësimit të tyre teknik, ka vendosur që pas pranimit të shfrytëzimit disa nga ato dhe pjesa e mbetur të transferohen tek komunat për shfrytëzim. Duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e objekteve për numrin e madh të institucioneve qendrore që do të funksionojnë, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar një plan të akomodimit i cili duhet të finalizohet deri në fund të këtij viti.

7. Zyrat Ndërlidhëse

- Në përgjithësi, është arritur progres i mirë në zbatimin e marrëveshjes mbi Zyrat Ndërlidhëse (ZN).
- Çështjet e pazgjidhura janë: simbolet dhe vultat e ZN dhe bashkëpunimi më i mirë ndërmjet ZN të Kosovës dhe zyrtarëve të Serbisë, të cilët zakonisht kanë shmangur këto takime. Serbia shmang diskutimet në arritjen e marrëveshjes mbi çështjet e tilla si vultat, simbolet dhe ballinat e letrave për më shumë se dy vite tani, edhe pse Kosova insiston në mënyrë të vazhdueshme.
- Serbia nuk ka treguar gatishmërinë për krijimin e bashkëpunimit me Zyrtarin Ndërlidhës të Kosovës në Beograd. Ne theksojmë me shqetësim se Zyrtari Ndërlidhës i Kosovës nuk është pritur nga qeveritarët e Serbisë për më shumë se dy vite. Kjo çështje ka kërkuar negociata shtesë gjatë këtij shtatori, rrjedhimisht një takim i parë zyrtar u zhvillua me ministrin e arsimit të Serbisë. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës ka pritur Zyrtarin Ndërlidhës të Serbisë menjëherë pas arritjes së marrëveshjes dhe ka qenë e hapur për bashkëpunim.
- Serbia kohë pas kohe shkel marrëveshjen, pasi që zyrtarët serbë në vizitat e tyre në Kosovë (kryesisht të fokusuar në veri) nuk angazhohen në frymën e

marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve, por në agjendën nacionaliste. Po ashtu, ka raste kur zyrtarët Serbë shkelin marrëveshjen duke hyrë në Kosovë pa leje.

8. Energjia

- Serbia ka dështuar në regjistrimin e dy kompanive të reja (për tregti, për furnizim dhe shërbime të mirëmbajtjes së distribucionit) në Kosovë, siç parashihet në marrëveshjes për energji të datës 25 gusht 2015.
- Arsyet për vonesa në regjistrimin e kompanive të reja janë të natyrës politike: (1) për të shmangur respektimin e ligjit të Kosovës për procesin e regjistrimit të kompanive dhe (2) vendosjen e pengesave që Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) të filloj operimin si një sistem i pavarur në kuadër të sistemit Evropian të transmisionit, bazuar në marrëveshjen e arritur ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E më 1 tetor të vitit 2015. Zbatimi i kësaj marrëveshje është paraparë për 30 nëntor të vitit 2015 duke e kushtëzuar Kosovën me lëshimin e një licence për furnizim për një kompani të re. Por, Kosova nuk ka mundësi të lëshojë një licencë të tillë sepse kompania e re nuk është regjistruar ende.
- Serbia ende refuzon qasjen në veri të operatorëve të energjisë në Kosovë (KOSTT dhe KEDS), duke shkelur kështu marrëveshjen për Energjinë. Qasja në pjesën veriore të vendit duhet të fillojë menjëherë pasi që KOSTT të fillojë funksionimin si një bllok i pavarur rregullues.

Më shumë detaje mbi gjendjen aktuale:

- Marrëveshja mbi zhbllokimin e zbatimit / konkluzionet e dakorduara më 25 gusht të vitit 2015 kanë ndihmuar në vazhdimin e progresit në procesin e zbatimit. Si rezultat, Kosova/KOSTT ka nënshkruar marrëveshjen e ndërlidhjes me ENTSO-E dhe anëtarët e saj. Kjo marrëveshje e ndërlidhjes u arrit, sepse Serbia tërhoqi ankesën e saj të paraqitur kundër Kosovës në pajtim me marrëveshjen për energjinë të vitit 2013.
- Sipas marrëveshjes së ndërlidhjes të KOSTT-ENTSO-E, operimi i pavarur i KOSTT si një bllok rregullues duhet të fillojë më 30 nëntor të vitit 2015. KOSTT ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe ka zhvilluar të gjitha testet e nevojshme, siç përcaktohet nga PG TSO KOSTT. Marrëveshja kushtëzohet me progresin e bërë në licencimin e kompanisë së re furnizuese nga autoritetet Kosovare; por, kompania e re nuk është regjistruar ende sepse deri më tani nuk i kanë dorëzuar dokumentet e korrigjuara të aplikimit. Dokumentet fillestare të aplikimit janë konstatuar të mos jenë në

harmoni me Ligjin e Kosovës siç kërkohet nga marrëveshja për energjinë. Kështu, Kosova konsideron se KOSTT nuk duhet të shtyj fillimin e funksionimit si një bllok i pavarur rregullues në datën e parashikuar për shkak të vonesave të kompanisë së re për ndjekjen e procedurave për regjistrimin dhe marrjen e licencës së furnizimit.

- Dy kompanitë e reja, njëra për tregti dhe tjetra për furnizim dhe shërbime të shpërndarjes nuk janë regjistruar ende në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës/ Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës sepse nuk kanë dorëzuar ende dokumentet e korigjuara të aplikimit në përputhje me Ligjet e Kosovës. Autoritetet Kosovare kanë dërguar në mënyrë të duhur udhëzimet për korigjimet nëpërmjet ndërmjetësuesit të BE-së, megjithatë vonesat në ri-dorëzim vazhdojnë.
- Pasi të jetë lëshuar certifikata për regjistrimin e biznesit, autoritetet e Kosovës do të lëshojnë në mënyrë të rregullt licencimin për dy kompani të reja në përputhje me marrëveshjen. Pasi që kompanitë të fillojnë operimin, ato duhet të hyjnë në diskutim sa i përket arritjes së marrëveshjeve me kompaninë ekzistuese të shpërndarjes KEDS si dhe bashkëpunimin e nevojshëm me KOSTT.
- Qasja e KOSTT dhe KEDS në pjesën veriore të Kosovës nuk është zgjidhur ende. Qasja në pjesën veriore të vendit duhet të fillojë menjëherë pasi që KOSTT të fillojë operimin si një zonë e pavarur rregulluese.
- Sa i përket operatorëve ilegal, përmes nënshkrimit të marrëveshjes, Serbia ka ri-konfirmuar zotimin e saj për shpërbërjen e operatorëve të tij të energjisë, të cilët operojnë në mënyrë ilegale në veri të Kosovës, një obligim që është vonuar që nga shatori i vitit 2014, përkatësisht pas nënshkrimit të planit të veprimit për energjinë.

9. Telekomunikacioni - kodi telefonik për Kosovën

- Serbia tashmë ka shkaktuar një vonesë në marrjen e kodit telefonik të Kosovës 383 nga ITU pasi që ka vonuar për dy muaj regjistrimin e një kompanie të re në Kosovë. Kompania e re është regjistruar, megjithatë, ende ekziston frika për vonesa të mëtejshme nga Serbia.

Më shumë detaje mbi gjendjen aktuale:

- Zbatimi i Planit të Veprimit të arritur më 25 gusht të vitit 2015 ka filluar me vonesa të shkaktuara nga Kompania e Re në aspektet e dorëzimit të aplikacionit për regjistrimin e biznesit dhe parregullsive të gjetura në aplikacion. Janë dashur dy muaj që Kompania e Re të korrigoj dokumentet e aplikimit në bazë të ligjit të Kosovës dhe pas dorëzimit, autoritetet Kosovare kanë lëshuar certifikatën e regjistrimit të biznesit brenda një dite pune (më 13 tetor 2015).
- Në anën tjetër, vonesa në regjistrimin e biznesit të Kompanisë së Re ka shkaktuar pothuajse dy muaj vonesë në marrjen e kodit telefonik të Kosovës nga ITU. Plani i Veprimit ka paraparë datën e 15 janarit të vitit 2016 për dhënien e kodit të vendit; ky afat është shtyrë për 1 mars 2016. Ne kërkojmë nga BE-ja që të monitorojë procesin dhe të mos lejojë vonesa të mëtejshme në marrjen e kodit telefonik të Kosovës, duke pasur parasysh se kemi pasur një vonesë prej më shumë se dy vite që nga arritja e marrëveshjes në vitin 2013.
- Sa i përket kodit telefonik shtetëror, Austria duhet të aplikojë më 1 janar të vitit 2016. Serbia duhet të paraqesë në mënyrë të rregullt një letër të zotimit duke deklaruar që nuk kundërshton dhënien e kodit telefonik nga ITU.
- Kosova dhe ITU duhet të fillojnë bashkëpunimin sa i përket dhënies së kodit, siç kërkohet nga plani i veprimit. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të Kosovës që të takohet me zyrtarët e ITU, nuk ka pasur përgjigje pozitive nga ata. Ne thërrasim BE-në që të kontribuojë për fillimin e një bashkëpunimi të tillë.
- Autoritetet Kosovare do të ofrojnë një autorizim të përkohshëm të një fushëveprimit të kufizuar për shërbime të telefonisë mobile dhe një autorizim të plotë për telefoninë fikse për një kompaninë e re tanimë të regjistruar, ashtu siç parashihet në marrëveshje. Autorizimi i përkohshëm do të skadojë pasi që operatori i tretë mobil fillon operimin pas shpalljes së një tenderi ndërkombëtar në Kosovë.

- Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet dy palëve nëpërmjet ndërmjetësuesit të BE-së është në proces të realizimit. Vonesat janë për shkak të arsyeve të përmendura më lartë, ku madje nuk është përmbushur edhe afati i dytë për një nëntor të vitit 2015, siç është paraparë me Planin e Veprimit.

10. Doganat

- Zbatimi i marrëveshjes është mjaft i kënaqshëm. Ka ende pengesa për shkak të strukturave paralele të Serbisë.
- Serbia nuk i ka shpërbërë ende strukturat e saja paralele doganore në Kosovë. Serbia duhet të largojë strukturat paralele në Kosovë nga organogrami i Administratës Doganore të Serbisë. (shih linkun për organogramin i cili tregon se dogana në Prishtinë është ende pjesë e administratës doganore të Serbisë.
<http://www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx>)
- Përdorimi i vulave të strukturave paralele doganore vazhdon kohë pas kohe, duke shkelur kështu marrëveshjen për vulat doganore. Ka dëshmi për shkelje të tilla. Kohëve të fundit, më 15 nëntor të vitit 2015, në pikë-kalimin kufitar në Merdar janë gjetur pesë Dokumente të Veçanta Administrative të vulosura me vula të institucioneve paralele të Serbisë me mbishkrimin e të ashtuquajturës “Carinarnica Pristina & Kosovska Mitrovica” (Dogana e Prishtinës dhe Mitrovicës së Kosovës) dhe tri të tjera në PKK Dheu i Bardhë më 16 nëntor 2015.

11. MIK / IBM - objektet e përhershme

- Serbia nuk ka filluar ende me zbatimin e marrëveshjes mbi objektet e përhershme të IBM. (nënshkruar në shtatorin e vitit të kaluar dhe i financuar nga BE-ja)
- Nuk i ka miratuar ende vendimet mbi shpronësimin e tokës së nevojshme për objektet /ndërtesat e përhershme për PKK-të.
- Kosova ka miratuar të gjitha vendimet e nevojshme mbi çështjen e shpronësimit dhe ka dorëzuar tek Agjencia Zbatuese (UNOPS) planin e veprimit me të gjitha masat që duhet të ndërmerren për fillimin e ndërtimit në fillim të vitit të ardhshëm.

- Shumicën e kohës zbatimi i Ndihmës së Ndërsjellët Juridike ka dështuar nga Serbia që nga janari i vitit 2013, për t'u ndërprerë përfundimisht në tetor të vitit 2014. Pas një viti të mos-zbatimit, Serbia premtoi për ri-fillimin e zbatimit të NNJ, por deri më sot Serbia nuk është përgjigjur në kërkesën e Kosovës, së paku jo deri më tani.
- Gjatë këtij muaji, Serbia ka filluar të zbatojë në fushëveprim të plotë, marrëveshjen për SEED (Shkëmbimin Sistemik të të Dhënave Elektronike mbi Doganat) pas një viti vonesë.

12. Liria e lëvizjes

- Serbia nuk është duke lejuar shtetasit e vendeve të treta që të hyjnë në Serbi nga Kosova.
- Serbia nuk ka zbatuar marrëveshjen për targa e makinave – targa ilegale të makinave përdoren ende në pjesën veriore të Kosovës. Serbia vazhdon të lëshojë targa ilegale (KM, GL, PR, etj.).
- Serbia aplikon masa diskriminuese mbi targa e regjistrimit RKS (duke i ndërruar ato me targa provuese) përderisa refuzon reciprocitetin nga ana e Kosovës, të paraparë me marrëveshje. Kosova ka toleruar këtë asimetri për hir të lëvizjes së lirë të njerëzve, megjithatë, është e përcaktuar të aplikohet reciprociteti nëse Serbia nuk do t'i ndërpres masat diskriminuese që zgjasin për më shumë se katër vite.
- Serbia duhet të largojë aplikimin e Dokumenteve të Hyrjes dhe Daljes; dokumenti nuk përbën ndonjë masë të sigurisë dhe përbën një barrë për lirinë e lëvizjes nëpërmjet shpenzimit të panevojshëm të kohës.
- Serbia është duke bllokuar kohë pas kohe lirinë e lëvizjes për qëllime politike (rasti i PKK në Multivodë në ditën e zgjedhjeve lokale në Medvegjë më 13 shtator 2015, me qëllim të panundësorë që votuesit shqiptar të shkojnë të votojnë).
- Kosova ka ndërmarrë disa hapa për të lehtësuar konvertimin në targa legale (KS apo RKS) duke ofruar fleksibilitet në këtë proces; fleksibilitet të tillë si kohën e shkurtër të administrimit, konvertim pa pagesës në targa legale,

pranimin e pagesës së taksave për automjetin në një doganë (që nënkupton pranimin e pagesës së tillë të bërë në Serbi) etj. Shumica e Serbëve të pjesëve të tjera të Kosovës kanë zëvendësuar targarat ilegale me targa të legale të makinave, por Serbët e katër komunave veriore, të udhëzuar nga Serbia, kanë refuzuar ta bëjnë këtë.

- Kosova është duke kryer përgatitjet teknike mbi tri çështje:
 1. Reciprociteti me Serbinë në çështjen e targave të makinave, në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit mbi Lirinë e Lëvizjes (LeL) dhe Planin e Veprimit. Kjo nënkupton se nëse Serbia nuk është e gatshme të largojë targarat “provuese” që aplikohen për targarat e makinave RKS që hyjnë në Serbi, Kosova do të aplikojë masa reciproke bazuar në marrëveshje.
 2. Gjithashtu, Kosova do të zbatojë plotësisht Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes për largimin nga trafiku të targave ilegale të makinave që përdoren ende (KM, GL, PR, etj.) nga disa qytetarë, edhe pse shumica e tyre tashmë janë larguar pasi që qytetarët i kanë zëvendësuar ato me targa të vlefshme. Periudha e tranzicionit nga targarat ilegale në ato të vlefshme do të ofrojë kohë optimale për kalim, duke pasur parasysh se vitin e ardhshëm skadon periudha për një kalim të tillë.
 3. Edhe pse nuk ndërlihet me Marrëveshjen për Lëvizjen e Lirë, në harmoni me përpjekjet e qeverisë së Kosovës për vendosjen e ligjit dhe rendit në trafik, Kosova do të adresojë çështjen e automjeteve të paregjistruara duke ndërmarrë masa për të siguruar se të gjitha automjetet që marrin pjesë në trafik duhet të regjistrohen. Do të vendoset një afat për zbatimin e masave të tilla.

13. Largimi i barrikadës nga Ura e Mitrovicës / Liria e Lëvizjes

- Revitalizimi i Urës së Mitrovicës ka filluar më 17 tetor të vitit 2015 (me dy ditë vonesë). BE-ja është përgjegjëse për procesin e revitalizimit. Duhet të finalizohet deri në qershor të vitit 2016 kur ura do të hapet për gjithë trafikun. Serbia ka qenë bashkëpunuese deri më tani.
- Një lëvizje pozitive është bërë nga banorët Shqiptarë me 20 tetor të vitit 2015, të cilët larguan monumentin në sheshin e fshatit Suhadoll, i ndërtuar si reagim ndaj barrikadës (“parku i paqes”) në urën e Mitrovicës.

14. Ndërtimet ilegale të Serbisë në Mitrovicën Veriore

- Serbia duhet të ndalojë ndërtimet ilegale të banimit kolektiv në Mitrovicën Veriore që synojnë ndryshimin e strukturës etnike. Shqiptarët pengohen që të kthehen dhe ndërtojnë shtëpitë e tyre.
- Serbia duhet të ndalojë pengimin e zbatimit të marrëveshjes të datës 25 gusht 2015, e cila bën thirrje për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) mbi krijimin e planeve ligjore komunale të zhvillimit urban në Mitrovicën veriore. Kryetari i komunës së Mitrovicës, G. Rakic, refuzon të nënshkruaj këtë MM më Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, nën pretekstin se nuk njohin hartat e Ahtisarit mbi kufirin administrativ ndërmjet Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore. MM duhet të nënshkruhet edhe nga kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore, A. Bahtiri, i cili ka konfirmuar gatishmërinë e tij. MM do të përcaktojë edhe hartat e kufijve administrativ të zonave kadastrale në Suhadoll/Suvi Do dhe Kroi i Vitakut/Brdjani, siç kërkohet me marrëveshje.
- Në përputhje me marrëveshjen, më 10 tetor 2015, autoritetet Kosovare kanë prezantuar hartat e Ahtisarit mbi kufijtë administrativ ndërmjet Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore.

15. Kadastrri

- Kuvendi i Kosovës ka paraparë miratimin e projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave (AKKVP). Kosova ka zhvilluar draft organogramin e AKKVP dhe është duke planifikuar hapat e mëtejshëm.
- Serbia duhet të përshpejtojë procesin e skanimit të dokumenteve kadastrale të cilat i mbajnë.

16. Fondi zhvillimor

- Fondi zhvillimor është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Aktualisht ky fond është rreth 8 milionë Euro, i mbledhur nga tatimet e kompanive që operojnë në katër komunat veriore dhe për mallrat e destinuar për qytetarët e këtyre komunave.
- Bordi ka miratuar në parim katër projekte (koncept dokumente) për Komunën e Mitrovicës Veriore, projekt-propozimet e tjera të komunave tjera do të shqyrtohen në takimet e ardhshme të Bordit. Shuma e përgjithshme e fondeve të alokuara deri më tani për tri projektet e para është 1,407,900 €.

17. Bashkëpunimi rajonal

- Është arritur progres i rëndësishëm në pjesëmarrjen si dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat dhe iniciativat rajonale.
- Serbia vazhdon të shkelë këtë marrëveshje duke vendosur pengesa në angazhimin e Kosovës për anëtarësimin e saj. Serbia duhet të mbështesë përfaqësuesit e Kosovës në strukturat menaxhuese dhe administrative në organizatat rajonale.

18. Diplomat

- Serbia ka dështuar në zbatimin e marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare për më shumë se katër vite që nga arritja e marrëveshjes.
- Rreth 400 aplikacione presin për njohje në zyrat e SPARK në Serbi, të cilat ishin certifikuar nga Shoqata Evropiane e Universiteteve (EAU), siç kërkohet nga marrëveshja.
- Marrëveshja e re mbi zhbllokimin e njohjes së ndërsjellë të diplomave universitare, e arritur më 29 shtator 2015, është kundërshtuar menjëherë në disa pjesë të saj nga Serbia, prandaj procesi i negociatave në këtë çështje vazhdon.
- Kosova konsideron se refuzimi i Serbisë që të njohë diplomat universitare të Kosovës përkon me politikën diskriminuese kundër komunitetit Shqiptar të Luginës së Preshevës. Dihet se shumica e studentëve Shqiptarë nga ky rajon janë të diplomuar në universitetet e Kosovës dhe të njëjtin do të përfitonin nga kjo marrëveshje.
- Që nga data 9 shtator 2015, Serbia ka bllokuar tekstet shkollore të Kosovës të dhuruara për Shqiptarët e Luginës së Preshevës.

19. Sigurimi i automjeteve

- Zbatimi i marrëveshjes ka qenë i kënaqshëm. Ka filluar më 12 gusht 2015, pas më shumë se tri vite negociata.

20. Certifikatat e Produkteve Farmaceutike - CPF

- Zbatimi i kësaj marrëveshje rifilloi pas 6 muajve vonesë; autoritetet Kosovare, më 5 nëntor të vitit 2015, kanë pranuar një formular të aplikimit nga CPF i cili përmban elementet e dakorduara në takimet për Dialogun e Brukselit.

Sinqerisht,



Edita Tahiri
Ministre për Dialog
Kryenegociatore në Dialogun e Brukselit

Për më shumë informacione mbi këtë proces, marrëveshjet dhe raportet mbi gjendjen në zbatim, ju lutemi referojuni ueb-faqes zyrtare të Qeverisë së Kosovës: <http://www.kryeministriks.net/?page=2,252>